



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 448 Prot.

Tiranë, më 06.02.2024

URDHËR

Nr. 5 datë 06.02.2024

"PËR
HAPJEN E THIRRJES PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË
"SHKENCA SPORTIVE" DHE "AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI"
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Mbështetur në Ligiin Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, Për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë", në Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në zbatim të Urdhërave të MAS, Nr.95, datë 25.2.2022 dhe Nr.98, datë 25.2.2022, "Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë Doktorate në "Shkenca Sportive" dhe "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"; në vijim të shkresës së MAS "Kthim Përgjigje" me nr. 7773/3 Prot., datë 02.2.2024 (e rregjistruar në UST me nr.3454/3 Prot., datë 05.2.2024),

URDHËROJ:

- Hapjen e thirrjes për pranimet në programet e studimit të ciklit të tretë Doktorate në:
 - "Shkenca Sportive" në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes
 - "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.
- Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë "Doktoratë" në Universitetin e Sporteve të Tiranës, do të kryhen nga data 07.2.2024 deri në datën 07.3.2024.
- Ky Urdhër i përcillet Njësive Kryesore të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Agron Kasa

